

VENDIM
Nr. 718, datë 5.12.2018

**PËR REVOKIMIN E TRANSFERIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 285, DATË 21.5.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E DISA PRONAVE, NË PRONËSI TË BASHKISË
TIRANË, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, njësisë administrative Tiranë, të pronave me numër rendor 15 e 19, të lidhjes 1, bashkëlidhur vendimit nr. 285, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave.

2. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 285, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, pronat me numër rendor 15 e 19, sipas formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, hiqen.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Per inventarizim e pronave te vecanta)

[illegible]

(Per inventarizările pronavete veçanta)

19	8228 P-7	7/46	Trusë Ndërtim	Ndërmarrja Metalike Tiranë Rreptëri i Orazve Rr. Ndre Mjeda	4153.77	1640	Prodhim Qera	Bashkia	Nd Metalike Tirana	shitet	7/257 v.15, fq 183 lista e bashkëpr.
20	8310	8/862	Trusë	Ndërmarrja Metalike Tirana Rr. P. Dardha	1191	894.34	Prodhim Qera	Bashkia	Nd Metalike Tirana	blitet v.45, fq 229	